



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "PETRO SOTA" FIER

Nr 547 Prot

Fier, më 10/10/2023

Lenda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dheformimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit";

Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet e mëposhtme për personelin në strukturë, me kohë të plotë ,mësimdhënës të teorisë profesionale:

- 1)Mësimdhënës të teorisë profesionale -1 ing mekanik
- 2) Mësimdhënës të teorisë profesionale- 1 ing mekatronik
- 3) Mësimdhënës të teorisë profesionale -1 Mësues TIK

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljesdhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesionale të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të mësipërme;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

-letërmotivimin për pozicionin;

-jetëshkrimin (CV-në);

-kartën e identitetit;

-diplomën;

-Librezën e punës

-çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

-certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive teknologjinë e informacionit;

-vërtetim të gjendjes shëndetësore;

-vërtetim të gjendjes gjyqësore;

-vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e sekretarisë së Shkollës së mesme profesionale "Petro Sota" Fier, brenda datës 02/11/2023

DREJTORI I SHKOLLËS

ARTA LEKA

